



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 013/26 Dt. 09.01.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Beledijesi

**Procesverbali i takimit të dytë publik me qytetarë për raportin e punës për
periudhën Janar-Dhjetor 2025**

Takimi publik me qytetarë është organizuar nga kryetari i komunës, Shaqir Totaj, drejtorët e drejtorive komunale, ky takim është bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 92 të Statutit të Komunës së Prizrenit me Nr. 01/011-5643.

Publikimet:

-**Me 16.12.2025**, konform afateve ligjore janë publikuar njoftimit në webfaqen zyrtare të komunës, në platformën e konsultimeve publike si dhe në rrjetin social facebook.

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/12/Njoftim-per-mbajtjen-e-TAKIMIT-TE-DYTE-publik-me-qytetare.pdf>

Në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/1XQdThXc1F/>

Në platformë:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42956>

Njoftimi si lajm:

<https://prizren.rks-gov.net/news/njoftim-per-mbajtjen-e-takimit-te-dyte-publik-te-kryetarit-te-komunes-se-prizrenit-shaqir-totaj/>

Lajmi për mbajtjen e takimit:

<https://prizren.rks-gov.net/news/takimi-i-dyte-publik-i-kryetarit-shaqir-totaj-me-qytetaret-per-vitin-2025/>

Takimi ka filluar në orën:09:15

Ymer Berisha, Udhëheqës i Njesisë për Komunikim me Publikun, e ka hapur takimin duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke theksuar rëndësinë e këtij organizimi. Ai ka deklaruar se qëllimi i takimit është informimi i qytetarëve përmes dëgjimit të raportit të Kryetarit të Komunës lidhur me punën dhe angazhimet e realizuara gjatë vitit 2025, si dhe krijimi i një hapësire për komunikim të drejtpërdrejtë dhe transparencë ndërmjet institucioneve komunale dhe qytetarëve.

Shaqir Totaj, kryetar i Komunës së Prizrenit ka prezantuar raportin për vitin 2025 duke thënë se ky raport përmbledh punën institucionale të Komunës së Prizrenit gjatë vitit 2025. Ai synon të pasqyrojë jo vetëm aktivitetet dhe statistikën e realizuara, por mbi të gjitha drejtimin, prioritetet dhe ndikimin konkret të punës komunale në jetën e qytetarëve.

Viti 2025 ka qenë vit pune intensive, konsolidimi institucional dhe vazhdimësie të projekteve strategjike. Në një realitet me sfida të vazhdueshme ekonomike, sociale dhe infrastrukturore, Komuna e Prizrenit ka ruajtur funksionalitetin, stabilitetin financiar dhe orientimin drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

Ky raport i shkurtuar është ndërtuar për t'u lexuar publikisht dhe për të reflektuar thelbin e punës institucionale, duke ruajtur besnikërinë e plotë ndaj raportit të detajuar vjetor.

Qeverisja dhe drejtimi institucional

Gjatë vitit 2025, Komuna e Prizrenit ka funksionuar mbi parimin e koordinimit të brendshëm institucional dhe përgjegjësisë kolektive. Drejtoritë komunale dhe njësitë vartëse kanë vepruar si një trup i vetëm administrativ, duke zbatuar politikat komunale dhe vendimet e organeve përkatëse.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar:

- koordinimit ndërmjet drejtorive,
- respektimit të procedurave ligjore,
- transparencës në vendimmarrje,
- komunikimit me qytetarët dhe institucionet partnere.

Gjatë vitit janë forcuar partneritetet me institucionet qendrore, organizatat ndërkombëtare dhe donatorët, duke krijuar hapësirë për mbështetje financiare dhe teknike në projekte zhvillimore.

Mesazhi kryesor i vitit 2025 ka qenë i qartë: Komuna duhet të funksionojë si institucion i besueshëm, i qëndrueshëm dhe i përgjegjshëm ndaj qytetarëve.

Financat dhe stabiliteti buxhetor

Menaxhimi financiar gjatë vitit 2025 është karakterizuar nga disiplinë buxhetore dhe transparencë. Të hyrat vetanake komunale janë realizuar në nivel mbi planifikimin, duke tejkaluar 10.7 milionë euro, ndërsa shpenzimet janë menaxhuar në mënyrë të kontrolluar.

Shpenzimet buxhetore për periudhën janar–nëntor 2025 kanë arritur mbi 65.5 milionë euro, me fokus në:

- paga dhe shërbime bazë,
- investime kapitale,
- subvencione dhe mbështetje sociale.
-

Ky menaxhim ka mundur vazhdimin e projekteve kapitale dhe garantimin e stabilitetit financiar të Komunës. Qasja e ndjekur ka qenë e qartë: paratë publike duhet të shërbejnë për interesin publik dhe të menaxhohen me përgjegjësi.

Investimet publike dhe infrastruktura

Gjatë vitit 2025 janë realizuar investime të rëndësishme në infrastrukturë dhe objekte publike. Fokus i veçantë i është dhënë:

- shëndetësisë,
- objekteve arsimore,
- objekteve kulturore dhe sportive,
- rrjetit të shërbimeve publike.

Janë avancuar projekte kapitale në ndërtimin dhe renovimin e qendrave shëndetësore, objekteve kulturore, infrastrukturës sportive dhe hapësirave publike. Këto investime kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe funksionimit urban.

Qasja e ndjekur ka qenë: më pak projekte në letër dhe më shumë projekte që qytetarët i shohin dhe i përdorin.

Administrata dhe shërbimet për qytetarë

Administrata komunale gjatë vitit 2025 ka përballuar një volum shumë të madh kërkesash administrative. Vetëm në sektorë kyç janë ofruar:

- mbi 80 mijë certifikata të gjendjes civile,
- mijëra shërbime administrative dhe teknike,
- përmirësim gradual i proceseve përmes digjitalizimit.
-

Njësia për Burime Njerëzore ka trajtuar mbi 2,700 kërkesa dhe ka zhvilluar dhjetëra procedura rekrutimi në sektorë jetikë si shëndetësia dhe arsimi.

Administrata ka qenë dhe mbetet mjeti kryesor për realizimin e politikave komunale, me synim që qytetari të marrë shërbim korrekt, në kohë dhe me respekt.

Siguria, emergjencat dhe inspektimet

Siguria publike ka qenë prioritet i vazhdueshëm. Gjatë vitit 2025:

- Brigada e Zjarrfikësve ka realizuar mbi 740 intervenime,
- janë zgjeruar dhe mirëmbajtur kamerat e sigurisë,
- është forcuar reagimi institucional në raste emergjente.
-

Drejtoria e Inspektorateve ka realizuar qindra inspektime në treg, ndërtim, mjedis dhe rend urban, duke kontribuar në mbrojtjen e interesit publik dhe zbatimin e ligjit.

Mesazhi institucional ka qenë i qartë: siguria nuk negociohet dhe ligji zbatohet për të gjithë.

Shëndetësia dhe mirëqenia sociale

Shëndetësia komunale gjatë vitit 2025 ka ofruar mbi 840 mijë shërbime shëndetësore për qytetarët.

Janë realizuar investime në:

- ndërtimin dhe renovimin e objekteve shëndetësore,
- furnizimin me pajisje mjekësore,
- përmirësimin e kushteve të punës për stafin shëndetësor.

Njëkohësisht, Komuna ka ofruar mbështetje financiare për qytetarët në nevojë, përmes subvencioneve dhe ndihmave sociale.

Qasja ka qenë e qartë: shëndetësia dhe mirëqenia nuk janë shpenzim, por investim në dinjitetin e qytetarëve.

Kultura, rinia dhe sporti

Prizreni gjatë vitit 2025 ka ruajtur identitetin e tij si qendër kulturore. Janë realizuar:

- investime në objekte kulturore dhe sportive,
- mbështetje financiare për OJQ dhe individë,
- organizim i festivaleve dhe ngjarjeve kulturore e sportive.

Këto aktivitete kanë kontribuar në gjallërinë e qytetit, përfshirjen e rinisë dhe promovimin e vlerave kulturore dhe sportive.

Kultura dhe sporti janë trajtuar si shtylla të identitetit dhe kohezionit shoqëror.

Gjithëpërfshirja dhe komunitetet

Komuna e Prizrenit ka vazhduar angazhimin për gjithëpërfshirje, barazi dhe respekt për diversitetin. Janë mbështetur komunitetet jo-shumicë, është forcuar roli i Zyrës për Komunitete dhe është avancuar bashkëpunimi ndërkulturor.

Integrimet evropiane dhe bashkëpunimi ndërkombëtar kanë qenë pjesë e vazhdueshme e agjendës komunale, me fokus në rritjen e kapaciteteve institucionale dhe harmonizimin me standardet evropiane.

Mesazhi ka qenë i qartë: Prizreni është qytet për të gjithë qytetarët e tij.

Përfundim

Viti 2025 për Komunën e Prizrenit ka qenë vit pune serioze, përgjegjësie institucionale dhe rezultateve konkrete. Ky raport i shkurtuar pasqyron një pjesë të rëndësishme të kësaj pune, ndërsa raporti i detajuar mbetet dokumenti zyrtar i plotë.

Komuna e Prizrenit do të vazhdojë të punojë me përkushtim për zhvillim të qëndrueshëm, shërbime cilësore dhe mirëqenie për qytetarët.

Falënderim i veçantë u drejtohet stafit komunal dhe qytetarëve për bashkëpunimin dhe besimin.


Fidan Syla:

Kur pritet të fillojnë punimet për hapjen e rrugëve në lagjen Dardania 2 dhe cili është shkaku i vonesës së deritanishme?


Takimi ka përfunduar në orën:09:40

Në këtë vegëz: <https://www.facebook.com/TVBESA/videos/888040613687092> , mund ta gjeni video incizimin e takimit.

Procesmbajtës:



Haziz Krasniqi



NJOFTIM PUBLIK

Ftojmë të gjithë qytetarët e Komunës së Prizrenit në takimin e dytë publik të kryetarit z. Shaqir Totaj.

Datë : 30.12.2025

Ora : 09:00

Vendi: Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës (Shtëpia e Bardhë).

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 92 të Statutit të Komunës së Prizrenit me Nr. 01/011-5643, Kryetari i Komunës së Prizrenit në bashkëpunim me Njësinë për Komunikim me Publikun organizojnë:

TAKIMIN E DYTË PUBLIK ME QYTETARË

Ftohen të gjithë qytetarët e Komunës së Prizrenit, OJQ-të dhe palët tjera të interesuara, se kryetari i Komunës së Prizrenit, z. Shaqir Totaj, mbanë takimin e dytë publik me qytetarë. Në këtë takim para qytetarëve kryetari raporton për punën njëvjeçare Janar-Dhjetor 2025.

Takimi Publik mbahet më: **30.12.2025** (e martë) në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës (Shtëpia e Bardhë), me fillim në orën **09:00**.

Takimi është i hapur për qytetarët, i hapur për parashtrimin e pyetjeve adresuar kryetarit dhe ekzekutivit të Komunës për të gjitha temat të cilat atyre ju interesojnë.

Komentet dhe sugjerimet e tua mund t'i dërgoni deri me datën: **29.12.2025** në ora **09:00**, në emailat:

Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net dhe Haziz.Krasniqi@rks-gov.net si dhe në formë fizike në këtë adresa: Rruga Adem Jashari Nr 275 Prizren 20000 (Shtëpia e Bardhë).

Raportet e punës së kryetarit të komunës mund t'i gjeni të publikuar në këtë veçorë: <https://prizren.rks-gov.net/raportet-e-kryetarit/>

Ymer Berisha
Udhëheqës i Njesisë për Komunikim me Publikun

pen: *[Signature]*


REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 645/25 Dt. 16.12.2025



PUBLIKUNO **PENJARIBE**

**Khara sa Prizrenoska
dizake dizunen pe duyto
publikuno kedipe e
sherunea r.Shaqir Totaj.**

Data: 30.12.2025

Ora: 09:00

**Than: Komunake
Sombeshipaski kedipyengi
sala (Parno Kher).**



Baziripea pe Kresi Gn. 03/L-040 vash Lokaluno Korkororaibe, artiklo 92 e Prizrenoska Komunake Statutesko Gn. 01/011-5643, Prizrenoska Komunako Sheruno pe ledeipe e Unia vash Komunikipe e Publika organizinena:

DUYTO PUBLIKUNO KEDIPE E DIZUNENCA

Khargyona sah Prizrenoska dizake dizune, BRO thay yaver interesime riga, kay o Prizrenoska Komunako Sheruno, r. Shaqir Totaj, adikerla o duyto publikuno kedipe dizunenca. Ko akava kedipe, anglo o dizune o sheruno ka raportinel vash yekhbershuni buti Januari-Decembri 2025.

O publikuno kedipe adikergyola pe: **30.12.2025** pe kedipyengi sala e Komunake Sombeshipasko (Parno Kher), shrdipea pe ora **09:00**.

O kedipe si phravdo vash o dizune, phravdo vash thovipe e puqipyengo adresime sheruneske thay Komunake ekzekutiveske vash o sah teme kola interesinena tumende.

Tumare komentya thay sugestie shay te biqhalen ji pe data: **29.12.2025** pe ora **09:00**, ko emailya:

Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net thay Haziz.Krasniqi@rks-gov.net.

Komunake sheruneske raportya shay te arakhen publikime ko akava link: <https://prizren.rks-gov.net/raportet-e-kryetarit/>

Ymer Berisha

per: *[Signature]*

Udhëheqës i Njësisë për Komunikim me Publikun


REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 645/25 Dt. 16.12.2025



KAMU BİLDİRİSİ

**Tüm Prizren Belediye
sakinleri Başkan Sn. Shaqir
Totaj'ın vatandaşlarla
düzenleyeceği ikinci
toplantıya davetlidirler.**

Tarih : 30.12.2025

Saat : 09:00

**Yer: Belediye Meclis toplantı
salonunda (Beyaz Ev).**

03/L-040 sayılı Yerel Öz Yönetim Kanun'un, 01/011-5643 sayılı Prizren Belediye Tüzüğü'nün 92. Maddesi gereğince Prizren Belediye Başkanı, Halkla İletişim Birimi ile işbirliğinde

VATANDAŞLARLA İKİNCİ TOPLANTIYI

organize etmektedir

Prizren Belediye sakinleri, STK'lar ve diğer ilgili taraflar Prizren Belediye Başkanı Sn. Shaqir Totaj'ın düzenlediği halkla ikinci toplantıya davetlidirler. İşbu toplantıda Belediye Başkanı 2025 yılı Ocak-Aralık dönemine ilişkin yıllık çalışmalarla ilgili vatandaşlara bilgi verecektir.

Söz konusu toplantı: **30.12.2025** (salı), saat **09:00** da (Beyaz Ev) Belediye Meclis toplantı salonunda düzenlenecektir.

Toplantı vatandaşlara açık olup, kendilerini ilgilendiren tüm konularda Belediye Başkanına ve Belediye yöneticilerine soru yöneltebilirler.

Yorum ve önerilerinizi: **29.12.2025** tarihinde saat **09:00** kadar: Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net ve Haziz.Krasniqi@rks-gov.net yetkililerin e – posta adreslerine iletebilirsiniz.

Belediye Başkan'ın raporlarını <https://prizren.rks-gov.net/raportet-e-kryetarit/> adresinde bulabilirsiniz.

Ymer Berisha

Halkla İletişim Birim Yöneticisi

Per: [Signature]

REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 645/25 Dt. 16.12.2025




JAVNO **OBAVEŠTENJE**

**Pozivamo sve građane
opštine Prizren na drugom
javnom sastanku
gradonačelnika g. Shaqir
Totaj.**

Dana: 30.12.2025

Vreme: 09:00

**Mesto: Sala za sednice
Skupštine Opštine (Dom
Kulture).**



Na osnovu Zakona br. 03/L-040 za Lokalnu Samoupravu, član 92 Statuta opštine Prizren br. 01/011-5643, gradonačelnik Opštine Prizren u saradnji sa Jedinicom za Odnose sa Javnošću organizuje:

DRUGI JAVNI SASTANAK SA GRAĐANIMA

Pozivaju se svi građani opštine Prizren, nevladine organizacije i druge zainteresovane strane, da gradonačelnik opštine Prizren g. Shaqir Totaj, održava drugi javni sastanak sa građanima. Na ovom sastanku gradonačelnik izveštava građane o jednogodišnjem radu januar-decembar 2025 godine.

Javni sastanak će se održati: **30.12.2025.** (utorak) u sali za sastanke Skupštine opštine (Bijela kuća), sa početkom od **09:00** časova.

Sastanak je otvoren za građane za postavljanje pitanja upućenih gradonačelniku i izvršnoj vlasti opštine o svim temama koje ih zanimaju.

Vaše komentare i sugestije možete slati do datuma: **29.12.2025** godine u **09:00** sati, na mejlove:

Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net i Haziz.Krasniqi@rks-gov.net.

Izveštaje gradonačelnika opštine možete pronaći objavljene na ovom linku: <https://prizren.rks-gov.net/raportet-e-kryetarit/>.

Ymer Berisha
Rukovodilac Jedinice za Odnose sa Javnošću

rev: *[Signature]*


REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 645/25 Dt. 16.12.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Lista e nënshkrimeve e qytetarëve pjesëmarrës në takimin e dytë publik me qytetarë të
organizuar nga kryetari i komunës, Shaqir Totaj:

Emaili dhe numri i telefonit do të përdoren për t'ju dërguar njoftime-ftesa për organizimin
e konsultimeve, takimeve dhe dëgjimeve publike.

Data e mbajtjes së takimit: 30.12.2025.

9:15"

Nr.	Emri	Mbiemri	Nr.Tel	Email	Gjinia	Nënshkrimi
1	JAKU	KORAJ	[REDACTED]	[REDACTED]		[Signature]
2	Fejtal	HOPI	[REDACTED]	[REDACTED]		[Signature]
3	BEKIM	THAQI	[REDACTED]	[REDACTED]		[Signature]
4	Fatmir	Badalli	[REDACTED]	[REDACTED]		[Signature]
5	SHPEJTIM	RAHAMAN	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
6	OSMAN	OSMAN	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
7	Nerhat	Macbeg	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
8	Dubi	Kadoll	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
9	QHEDER	IRAJ	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
10	Lulzim	Sylejzu	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
11	Ruzlidi	AZAZA	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
12	Remzije	Krosnig	[REDACTED]	[REDACTED]	F	[Signature]
13	Waq	Pejo	[REDACTED]	[REDACTED]		[Signature]
14	TEPIĆ	TRNOSTIĆ	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
15	Besnik	Osmanj	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Lista e nënshkrimeve e qytetarëve pjesëmarrës në takimin e dytë publik me qytetarë të
organizuar nga kryetari i komunës, Shaqir Totaj:

Emaili dhe numri i telefonit do të përdoren për t'ju dërguar njoftime-ftesa për organizimin
e konsultimeve, takimeve dhe dëgjimeve publike.

Data e mbajtjes së takimit: 30.12.2025.

Nr.	Emri	Mbiemri	Nr.Tel	Email	Gjinia	Nënshkrimi
1	AJET	SHALA	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
2	Vjollca S	Gungule	[REDACTED]	[REDACTED]	F	[Signature]
3	Jehona	Selimi	[REDACTED]	[REDACTED]	F	[Signature]
4	Ajben	Shaku	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
5	Qarhim	Montpa	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
6	Hasan	Kreshnja	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
7	AFERDITA	KORÇODINA	[REDACTED]	[REDACTED]	F	[Signature]
8	RELIVANI	PULAJ	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
9	Adelina	Hoxhaj	[REDACTED]	[REDACTED]	F	[Signature]
10	ISMET	RUSTENI	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
11						
12						
13						
14						
15						